



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

Legjislatura III

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,  
Personat e Pagjetur dhe Peticione  
Nr. 09-  
Prishtinë, më 13.5. 2008, në orën 13,00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

**P R O C E S V E R B A L**

i mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Personat e  
Pagjetur dhe Peticione

**Morën pjesë:** Ismet Beqiri - kryetar, Hajredin Hyseni, Radmila Vujoviç, Sanije Alijaj,  
Luljeta Shehu, Ibrahim Makolli, Nerxhivane Dauti, Naim Rrustemi, Drita Maliqi dhe  
Shpresa Murati - anëtarë.

**Në mbledhje ishin të pranishëm:**  
Xhemajl Ahmeti – nga UNHCR  
Lejla Selimi dhe Elita Vokshi – nga OSBE  
Fitore Zeneli – nga KDI

Kryetari ia propozoi Komisionit këtë

***REND DITE***

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të 22. 4. dhe 6. 5. 2008
2. Miratimi i planit të punës së Komisionit për vitin 2008
3. Nxjerrja e përfundimeve nga dëgjimi publik që ka të bëjë me peticionin e punëtorëve të ndërmarrjes “Kompresor” nga Gjakova
4. Të ndryshme

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

U hap diskutimi për pikën e parë.

### **1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të 22.4. dhe 6.5.2008**

**Ibrahim Makolli** - Kërkoi që emri i shkollës “Sami Frashëri” të zëvendësohet me “Naim Frashëri”. Ai sugjeroi që në të ardhmen procesverbalet të jenë të shkurtra dhe koncize. Pasi nuk pati vërejtje, procesverbalet u miratuan.

**Nerxhivane Dauti** - Duke u ndërlidhur me hartimin e procesverbaleve, kërkoi nga anëtarët e Komisionit të mos e marrin fjalën disa herë, ngase kjo do t’ju ndihmojë juve dhe hartuesit të procesverbalit. Diskutimi i saj u mirëprit nga kryetari që theksoi se teknika e hartimit të procesverbalit është e vështirë.

### **2. Miratimi i planit të punës së Komisionit për vitin 2008**

**Ismet Beqiri** – Tha se në mbledhjen e kaluar në parim e kemi miratuar planin. Në vazhdim theksoi se nuk do të thotë që ky nuk do të plotësohet, sidomos lidhur me vizitat që do t’i kemi jashtë dhe brenda Kosovës. Këto vizita kanë për qëllim të shihet gjendja reale në terren me të cilën ballafaqohen qytetarët, si dhe për ta vlerësuar punën që e bëjnë institucionet në shërbim të qytetarëve për personat e pagjetur.

**z.Ibrahim Makolli** - E ngarkoi Komisionin që ta plotësojë planin e punës të fushës e të drejtave të njeriut. Pas një diskutimi të gjerë dhe konstruktiv Komisioni me votim formal për këtë pikë e nxori këtë:

## **P e r f u n d i m**

Komisioni e miratoi planin e punës për vitin 2008

### **3. Nxjerrja e përfundimeve nga dëgjimi publik që ka të bëjë me peticionin e punëtorëve të ndërmarrjes “Kompresor“ nga Gjakova**

Kryetari i njoftoi të pranishmit për rrjedhën e dëgjimit publik dhe shprehu keqardhje që znj. Nerxhivane Dautit, për shkaqe objektive nuk mori pjesë. Ai tha se dëgjimi publik kishte të bënte me shqyrtim e peticionit të punëtorëve të ndërmarrjes “Kompresor “ nga Gjakova, që ishin larguar nga puna dhe me privatizimin i ndërmarrjes që ishte bërë në valën shtatë. Për këtë pikë e hapi debatin.

**Hajredin Hyseni** – Nënvizoi se AKM-ja e ka bërë privatizimin e sipas mënyrës së privatizimit klasik që AKM-ja e ka zbatuar në ndërmarrjen “Kompresor”. Ai kërkoi nga

Komisioni që propozimi i tij për pagat e papaguara të hyjë si rekomandim. Propozimi gjeti mbështetje të kryetari dhe anëtarët e Komisionit.

**Ibrahim Makolli** – Duke u ndërlidhur me parafolësit për privatizimin e ndërmarrjeve, e vlerësoi si shqetësuese gjendjen dhe e fajësoi AKM-në që nuk i ka plotësuar kushtet e parapara me rregulloret nr. 2003/13 dhe 2006/17 të UNMIK-ut.

Kërkesat e shtruara nga punëtorët që dolën nga dëgjimi publik, të mbajtur më 6. 5. 2008, i shtroi në formë të rekomandimeve si vijon:

- Të kërkohet nga AKM-ja që urgjentisht t’u jepen punëtorëve pagat e papaguara.
- Të kërkohet nga institucionet e Republikës së Kosovës, përkatësisht nga Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale që ata punëtorë që i kanë plotësuar kushtet për pensionim të pensionohen.
- Të kihet kujdes që në ato ndërmarrje, ku nuk është zbatuar privatizimi, të mos përsëritet i njëjti gabim dhe të eliminohen pasojat që i dëmtojnë punëtorët. Ndërsa për kërkesat lidhur me punësimin si dhe për daljen në pension mbi moshën 35-vjeçare të kërkohet analizë paraprake.

**Sanije Alijaj** – Duke u ndërlidhur me parafolësit për kërkesat e punëtorëve të dala nga dëgjimi publik, shtoi : petitionet janë në vazhdimësi nga legjislaturat e mëparshme të cilave u kemi dhënë përgjigje. Por punëtorët e ndërmarrjes “Kompresor“ nga Gjakova kanë ardhur me kërkesa konkrete si vijon: Kërkesa e parë ishte pagat e mbetura borxh nga AKM-ja, ndërsa kërkesa e dytë ishte pensionimi mbi moshën 35-vjeçare, që është e dëshirueshme, por e perealizueshme, ngase nuk mund të realizohet me asnjë normë ligjore. Kërkesa fundit ishte t’u gjenden atyre vende pune. Ajo e mirëpriti pagesën e dhënë punëtorëve prej 20% nga ana e AKM-së, edhe pse kjo ishte bërë me vonesë.

**Nerxhivane Dauti** – Duke ndërlidhur me parafolësit e mbështeti mendimin e z. Makolli dhe propozoi të merren për bazë rekomandimet e tij.

Pas një debati të gjerë dhe konstruktiv, që u zhvilluar nga të pranishmit për këtë pikë, Komisioni nxori këtë:

#### P e r f u n d i m

1. Nga Qeveria e Republikës së Kosovës kërkohet të angazhohet për pagesën e pagave të mbetura borxh nga përfituesi i privatizimit “Kompresor“ nga Gjakova.
2. Nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale rekomandohet të gjendet mundësia për pensionim të parakohshëm, vetëm për punëtorët e shtyrë në moshë, që vlerësohet se për afërsisht i plotësojnë kushtet për një pensionim të paraparë me ligj.
3. Kërkohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës që si preventivë për moslejimin përkeqësimit të gjendjes sociale të përshejtohet edhe procedura e nxjerrjes së ligjit për sigurimin pensional dhe invalidor dhe për krijimin e fondit përkatës.

4. Kërkohej nga Qeveria e Kosovës që gjatë privatizimit të ndërmarrjeve në të ardhmen të ketë kujdes të mos përsëriten gabimet dhe t'i eliminojë pasojat që i dëmtojnë punëtorët.

#### **4. Të ndryshme**

Komisioni duke vlerësuar se numri i lëndëve që paraqiten nga qytetarët po shënon ngritje, vendosi që në të ardhmen ta përshpejtojë shqyrtimi e tyre dhe mori qëndrim që të shtohet numri i mbledhjeve të Komisionit në të cilat si pika të rendit të ditës do të jenë edhe peticionet.

Mbledhja përfundoi në orën 14: 20.

Procesverbalin e hartoi  
Rrahim Demaj - zyrtar i lartë ligjor

Kryetari i Komisionit  
Ismet Beqiri